



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2019:282634

Datë: 16.09.2024

Numri i dokumentit: 06165714

K.DH.SH.II.nr.121/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Ramush Bardiqi kryetar, Dren Rogova dhe Krenar Berisha, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Ipko Telecommunications LLC, me seli në Prishtinë, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Isamedin Dedinca, avokat nga Prishtina kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.249/22 të datës 11.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 02.09.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

II. APROVOHET si e bazuar ankesa e paditësit Ipko Telecommunications LLC, me seli në Prishtinë.

II. PRISHET Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.249/22 i datës 11.10.2023, dhe çështja i kthehet në rigjykim dhe rivendosje gjykatës së shkallës së parë.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.249/22 të datës 11.10.2023, është refuzuar propozimi i paditësit Ipko Telecommunications LLC me numër te biznesit 70064420, me seli ne Prishtinë, për anulim të Vendimit Nr. 409/19 të datës 04.09.2019 të nxjerrë nga e paditura Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, si e pabazuar.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të LKA-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozimin që ankesa e paditësit të miratohet si e bazuar, Aktgjykimi i ankomuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje me sugjerimin që Gjykata e Shkallës së parë të eliminoj të metat e këtij

aktgjykimi, ose të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar, ashtu që Dhoma e Shkallës së Dytë të vendos në mënyrë meritore duke e miratuar kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të bazuar dhe të anulohet si të kundërligjshëm vendimin e të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit nr.409/2019 të datës 04.09.2019.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjeti se:

Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se në procedurën administrative të ankesave, e paditura Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, me vendimin PSH. nr.327/17 i datës 29.09.2017, në pikën I të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e operatorit ekonomik “Telekomi i Kosovës” Sh.A lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Linja e internetit me brez të gjerë (500mbps) për Wifi në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës” me numër prokurimi: 101-19-3964-1-2-1 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – Kuvendi i Kosovës. Në pikën II të vendimit Anulohet njoftimi për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull të prokurimit “Linja e internetit me brez të gjerë (500mbps) për Wifi në ndërtesën e kuvendit të Kosovës” me numër prokurimi: 101-19-3964-1-2-1 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – Kuvendi i Kosovës. Në pikën III të dispozitivit Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. Në pikën IV Mosrespektimi i këtij vendimi, detyron Panelin Shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr.04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues. Në pikën V të dispozitivit Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Telekomi i Kosovës” Sh.A, aprovohet pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Në pikën VI Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 te rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës..

Paditësi i pakënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Paneli Shqyrtues i Prokurimit Publik, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 16.09.2019, me pretendim se vendimi i të paditurës është i pa drejtë dhe i paligjshëm.

Dhomat e shkallës së parë pas shqyrtimit të padisë së paditësve paraqitur kundër vendimit të paditurës OSHP-së, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor datës 14.09.2023, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin propozimin e paditësit e refuzon si të pabazuar me arsyetimin se gjykata vlerëson se në rastin konkret të Telekomit të Kosovës sh.a (ndërmarrje publike) plotësohen kushtet e sipërpërmendura në mënyrë, ashtu që kontrata e prokurimit publik në mes të Autoriteteve Publike Qendrore (Qeveria dhe Kuvendi), me Ndërmarrjen Publike Qendrore Telekomit të Kosovës sh.a. të zhvillohet procedura e përjashtimit “blerje në shtëpi” dhe “prokurim publikopublik”. Kjo praktikë është në harmoni me vet qëllimin primar të LPP-së, qëllimi i të cilit është siguria dhe efikasiteti i shfrytëzimit të fondeve publike dhe atë vetëm nëse bëhet veçanërisht për shkak të interesit publik dhe nuk ka për qëllim diskriminim e operatorit IPKO Telecommunication LLC. Megjithatë theksohet se përjashtimi nga procedura e rregullt e prokurimit duhet të vlerësohet në çdo rast konkret dhe të bëhet vetëm nëse plotësohen në mënyrë

kumulative kushtet Teckal, të përcaktuar nga CJEU-së (të theksuara me lart), në mënyrë që përjashtimi të jetë i kufizuar dhe të aplikohet vetëm në raste të caktuara. Prandaj, gjykata vlerëson se Vendimi i Panelit Shqyrtues Nr.409/19 të datës 04.09.2019 me të cilën aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Telekomi i Kosovës” sh.a, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull dhe anulohet vendimi për kontratë “Furnizim me linjë të internetit me brez të gjerë (500 MBPS) për WiFi në adresë të Kuvendit të Republikës së Kosovës”, me numër të prokurimit: 101-19-012-121 është në interes publik dhe nuk është në kundërshtim me parimet e trajtimit të barabartë dhe jo diskriminues ndaj operatorëve ekonomik dhe nuk ka për qëllim ta reduktoj konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik por të shfrytëzimin me racional të fondeve publike. Ne aktvendimin e atakuar tutje gjykata e shkallës e pare ka theksuar se është mese e domosdoshme qe ne raste te dilemave qofte ne mungesë te dispozitave te sakta ligjore apo ne mungesë se praktikës ne zbatimin e procedurës blerje ne shtepii ti referohet rregullave te prokurimit ne raste ne te cilat aplikohet procedura e blerjen ne zbatimin ne shtetet e BE-së, me ç ‘rast i është referuar Direktivave te Prokurimit Publik te BE-se -2014/24/EU (DPP).

Dhomat e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes duke ekzaminuar aktgjykimin e ankimuar, shkresat e lëndës edhe sipas pretendimeve ankimore, gjen se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika n) dhe i LPK-së, i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, se është juridikisht i pa qartë kundërthënës me vet vetën dhe arsyetimin e tij, dhe me zbatim te gabuar te te drejtës materiale ne nenin 184 te LPK-se, me te cilën parashihet se *Zbatimi i gabueshëm i së drejtës materiale ekziston kur gjykata nuk e ka zbatuar dispozitën e së drejtës materiale qe është dashur ta zbatojë, apo kur dispozitën e tillë nuk e ka zbatuar në mënyrë të drejtë.*

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes sipas aktvendimit të ankimuar, tani për tani, nuk e përkrah Dhoma e Shkallës së Dytë, për shkakun se kjo gjykatë me vlerësimin dhe analizimin e tërësishëm të shkresave të lëndës ka gjetur se aktvendimi i ankimuar është marrë me shkeljet thelbësor te dispozitave ligjor edhe vërtetimi jo te plot dhe te gabuar te gjendjes faktike për të cilën gjykata e shkallës së dytë çdo herë kujdeset sipas detyrës zyrtare ne kuptim te nenit 194 të LPK dhe e cila shkelje sipas vlerësimit të kësaj gjykate ka ardhur si shkak i vërtetimit jo te plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike me rastin e vendosjes nga ana e gjykatës se shkallës së parë. Për më tepër, dispozitivi i aktvendimit të ankimuar, është kontradiktor dhe në kundërshtim me arsyet mbi faktet vendimtare në të cilat është thirrur gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes, sepse i njëjti është marrë edhe me shkelje te dispozitave materiale pasi që në rastin konkret është zbatuar dhe interpretuar gabimisht e drejta materiale. Kolegji vlerëson se dispozitivi i aktvendimit të ankimuar, është kontradiktor me arsyetimin e aktvendimit i ankimuar, për arsye se, gjykata e shkallës se pare ne njërën ane ka konstatuar se ne bazë te dispozitave ligjore te Ligjit te Prokurimit, ndërmarrjet publike nuk i plotësojnë elemente e autoritetit publike, ndërsa ne anën tjetër furnizimet e tilla lidhur me aktivitetin e prokurimit nga Telekomi i Kosovës SHA si ndërmarrje publike i ka konsideruar si blerje ne shtëpi.

Kolegji nuk pajtohet me qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, për arsye se ne vështrim te dispozitës ligjore nga neni 4 par.1 pika 1.4 të Ligjit Nr.03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, i cili ka gene i zbatuar ne kohe ku është nxjerr vendimi kontestues me të cilin përcaktohet se “1. Ndalohe të gjitha marrëveshjet ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve të pavarura, vendimet e marrura ne mes te shoqatave të ndërmarrjeve dhe praktikata e bashkërenduar të cilat kanë për qëllim ose mund të ndikojnë në mënyrë të dukshme në çrregullimin e konkurrencës tregtare në tregun relevant e veçanërisht marrëveshjet që: 1.4. zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta me ndërmarrje të tjera tregtare, duke i vendosur ato në

gjendje të pafavorshme konkurruese”. Po ashtu, edhe dispozitave ligjore nga nenet 10 dhe 119 par.2 dhe 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ku me nenin 10 përcaktohet se “Ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë është bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës. Ndërsa me nenin 119 par. 2 dhe 3 përcaktohet se “2. Republika e Kosovës siguron të drejta ligjore të barabarta për të gjithë investitorët dhe të gjitha ndërmarrjet vendore dhe të jashtme. 3. Veprimet që kufizojnë konkurrencën e lirë përmes vendosjes ose abuzimit të pozitës dominuese, ose praktikave që e kufizojnë konkurrencën, janë të ndaluara, me përjashtim kur këto lejohen në mënyrë eksplicite me ligj”. Andaj kolegji vlerëson se favorizimet direkte dhe indirekte të ndërmarrje publike kundrejt operatorit privat, respektivisht një investitori të huaj, në një treg të rregulluar, përbëjnë shkelje jo vetëm të dispozitave të ligjit të sipërcekur, por edhe të aktit më të lartë juridik – Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila parasheh që bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës është ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë.

Kolegji vlerëson në kuptim të nenit 7 të Ligjit për prokurim nr. 04/L-042 parasheh se Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. 2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik. 3. Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohej që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledhë sasitë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik. 4. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik. Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kriterëve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse. Andaj në përmbajtje të dispozitave ligjore kuptohet se favorizimit të ndërmarrjeve publike dhe diskriminimit të ndërmarrjeve private dhe investitorëve të huaj në vend, nga autoriteteve publike të cilat kanë përgjegjësi për ofrimin e mjedisit të barabartë për të gjithë operatorët ekonomik, privatë dhe publikë, do të dëmtojë klimën e të bërit biznes në Kosovë.

Kolegji vlerëson se arsyetimit të vendimi i shkallës së parë është përfshirë me zbatim të gabuar të drejtës materiale kur e ka bazuar vendimin e atakuar në direktivën e BE, për arsye se direktivat e BE nuk janë të aplikueshme drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës. Direktivat e BE-se janë të aplikueshme vetëm nëse janë transpozuar në të drejtën e brendshme përkatësisht në legjislacion vendor, e me ç'rast aplikohet Ligjet e Republikës së Kosovës. Andaj duke marrë parasysh

konstatimet e lartecakura kolegji vlerëson se vendimi i atakuar nuk përmban një vlerësim të fakteve në raport me dispozitat ligjore, andaj një vendim i tillë nuk mund të quhet se është i drejtë dhe i ligjshëm dhe se është marr me respektimin e dispozitave ligjore në fuqi. Shkeljet e tilla përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore që kanë pasur ndikim në marrjen e aktvendimit të ligjshëm dhe të drejtë andaj aktgjykimi i atakuar, doemos është dashur të priset. Shkeljet e tilla respektivisht paqartësitë dhe kontradiktat e dispozitivit në raport me arsyetimin e aktgjykimit të atakuar përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore që kanë pasur ndikim në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë andaj aktgjykimi i atakuar doemos është dashur të priset.

Prandaj, kjo gjykatë tani për tani nuk mund të pranoj si të drejtë një konstatim të tillë të paraqitur në aktgjykimin e ankimuar, sepse ka të meta për të cilat nuk mund të ekzaminohet, dhe se është juridikisht i paqartë dhe i paqëndrueshëm. Gjykata e shkallës së parë, në ri procedurë, duhet të bëjë vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit kontestues, vendim i marrë nga e paditura, e që është objekt shqyrtimi në këtë çështje juridike. Gjykata e shkallës së parë, duhet ti shqyrtojë të gjitha vërejtjet e dhëna nga kolegji i kësaj gjykate, ti eliminoj të gjitha shkeljet e theksuara më lartë, të vendos në kuptim të nenit 160 të LPK-së, ashtu që dispozitivi dhe arsyetimi i vendimit të jetë i çartë dhe i kuptueshëm, të vendos për të gjitha kërkesat e palëve në procedurë, ti vlerësoj të gjitha provat veç e veç dhe të gjitha së bashku, dhe në fund të merr vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga te cekurat me lart, e në mbështetje të nenit 194, 195 parag. 1 pika (c) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
Dhomat e Shkallës së Dytë  
K.DH.SH.II.nr.121/24 datë 02.09.2024

Kryetar i Kolegjit, gjyqtari  
Ramush Bardiqi